



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
Republika e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta  
Ministry of Culture, Youth and Sports

4305/2022

22.09.2022

*Adga*

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth & Sports

**DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA**

Ligjin Nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregulloren (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

**Konkurs**

*Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	<b>Zyrtar për Barazi gjinore</b>
<b>Klasa e pozitës</b>	Zyrtar Profesional
<b>Koeficienti/Paga</b>	7
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	22.09.2022
<b>Afati për aplikim</b>	07.10.2022 - 14.10.2022
<b>Institucioni</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>Divizioni</b>	I Burimeve Njerëzore
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00009946
<b>Kodi</b>	RPC0003660

## **1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës**

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
3. Koordinon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave legjisacionit në fushën mbi barazinë gjinore, mundësitë e barabarta, kundër-diskriminim dhe anti-trafikimi;
4. Zhvillon projekte lidhur me barazia gjinore, mundësitë e barabarta dhe respekti i plotë i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në nivel komunal;
5. Koordinon programet lidhur me barazi gjinore në mënyrë që të zbatohet Ligji për Barazi Gjinore, Programi i Kosovë për Barazi Gjinore dhe standardet ndërkombëtare për të DNJ të aplikueshme në Kosovë;
6. Bashkëpunon me organizatat dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare dhe OJQ-të, në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të tjera, në realizimin e barazisë gjinore;
7. Përgatit raporte lidhur me zbatimin e politikave dhe legjisacionet dhe respektimin e barazisë gjinore, mundësive të barabarta; Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

## **2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta**

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mirë' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

## **3. Kërkesat e përgjithshme formale**

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare, Fakulteti ekonomik, juridik, fakulteti filologjik, fakulteti filozofik, me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

#### **4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme**

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

#### **5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim**

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.

#### **6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak**

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 17.10.2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

#### **7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë**

- 21.10.2022 ora 10:00, Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit

#### **8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë**

- Diploma universitare minimum 2 vite përvojë pune profesionale.
- Të ketë njohuri në legjislacionin dhe politikat vendore dhe standardet ndërkombëtare në lëmin e barazisë gjinore;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

#### **9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve / aplikantëve**

- Intervista

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Data e njoftimit në ëebfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej datës 22.09.2022. deri me datë 06.10.2022 **ndërsa data e aplikimit është nga data 07.10.2022 deri me datën 14.10.2022.**

Përveç ëeb faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Ëeb faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme. **Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shitesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921( apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).